

VENDIM
Nr. 18, datë 31.1.2017

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E
KONTRATËS PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET KESH
SHA DHE OSHEE SHA PËR TEPRICAT E ENERGJISË ELEKTRIKE, PËRFSHIRË
TEPRICAT NË KUSHTET E PRURJEVE TË MËDHA, ME QËLLIM PLOTËSIMIN E
HUMBJEVE NË RRJETIN E SHPËRNDARJES PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2017–
31.12.2017

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, nenin 5, pika 4, të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, që ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, dhe nenit 26 të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 23.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.1.2017, pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike të ERE-s për fillimin e procedurës për miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017-31.12.2017,

konstatoi se:

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 174, datë 7.11.2016, është vendosur miratimi i kontratës/marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.7.2016–31.12.2016;

- Shoqëria “OSHEE sh.a.”, me shkresën nr. 31126 prot., datë 23.12.2016 i ka përcjellë shoqërisë KESH sh.a. për nënshkrim kontratë/ marrëveshjen për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017–31.12.2017;

- Shoqëria “KESH sh.a.” nëpërmjet shkresës nr. 88 prot., datë 9.1.2017 i ka përcjellë shoqërisë OSHEE sh.a. për nënshkrim kontratë/ marrëveshjen për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017–31.12.2017;

- Kjo kontratë me nr. identifikimit prot. i KESH sh.a. 87, datë 9.1.2017 dhe prot. i OSHEE sh.a. 1306, datë 17.1.2017, është nënshkruar nga të dyja palët;

- U konstatua se ndryshimet në këtë marrëveshje, referuar përmbajtjes së marrëveshjes miratuar më herët me vendimin nr. 174, datë 7.11.2016 të Bordit të ERE-s, janë vetëm në funksion të përditësimit të kuadrit ligjor rregullator të miratuar më herët nga ERE me vendimin e sipërcituar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin dhe miratimin e kontratës/marrëveshjes për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2017–31.12.2017.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë palët e interesuara për vendimin e

Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti